

VENDIM
Nr. 35, datë 13.5.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BISTRICA 3 ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “BISTRICA 3” DHE
“BISTRICA 4”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bistrica 3 Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të “Bistrica 3 Energy” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Bistrica 3” dhe “Bistrica 4”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti